



Financuar nga
Bashkimi Evropian

EURALIUS
Consolidation of the
Justice System in Albania

Heqje dorë nga përgjegjësia:

Jeni të lutur të vini re se ky dokument përbën një konsolidim jozyrtar të destinuar vetëm për qëllime informimi. Teksti nuk jep asnjë të drejtë dhe nuk imponon asnjë detyrim të ndryshëm nga çfarë parashikohet në legjislacionin e miratuar dhe të botuar në Fletoren Zyrtare. EURALIUS nuk garanton saktësinë dhe nuk mban përgjegjësi për përdorimin që mund t'i bëhet informacionit të mëposhtëm.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

UDHËZIM

Nr. 146, datë 27.04.2020

PËR

**PËRCAKTIMIN E MASAVE PËR KUFIZIMIN E PËRHAPJES SË COVID-19 GJATË USHTRIMIT TË
VEPRIMTARISË GJYQËSORE DHE ADMINISTRATIVE NË GJYKATA**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 147/1, 147/a, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 61 dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, nenin 7, 36 dhe 38 të Ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", në Ligjin nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, në nenin 42 pika 1 të Ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile", Aktin Normativ të Këshillit të Ministrave nr. 9, datë 23.5.2020 "Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore gjatë kohëzgjatjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19"¹, me propozimin e Komisionit të Përkohshëm të ngritur me vendimin e Këshillit nr. 135, datë 16.04.2020 për hartimin, propozimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të një plani masash për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimeve gjyqësore në mënyrën më të sigurt të mundshme gjatë kohëzgjatjes së epidemisë së shkaktuar nga virusi COVID-19,

UDHËZON:

¹ Ky Akt Normativ është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Ligjin nr. 30/2020 "Për miratimin e Aktit Normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 25.3.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19".

Ministria e Drejtësisë,
Bolevardi "Zogu I"
Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 22 40 333
E-mail: info@euralius.eu
Web: www.euralius.eu



I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave orientuese në lidhje me masat organizative dhe administrative që duhet të merren nga të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore me qëllim parandalimin e përhapjes së Covid-19.
2. Rregullat e parashikuara në këtë udhëzim nuk cenojnë por janë pjesë dhe kanë për qëllim garantimin e një procesi të rregullt dhe ligjor gjatë kohëzgjatjes së epidemisë.

II. MASA TË PËRGJITHSHME TË HIGJENËS DHE DISTANCIMIT SOCIAL

Këshillat e Gjykatave si dhe organet e administrimit gjyqësor, sipas kompetencave të tyre të përcaktuara me ligj dhe në funksion të zbatimit të rregullimeve ligjore dhe akteve të nxjerra nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, të miratojnë masa organizative për zhvillimin e veprimtarisë gjyqësore ashtu dhe shërbimeve administrative të gjykatës gjatë kohëzgjatjes së epidemisë. Masat duhet të garantojnë organizimin dhe zhvillimin e proceseve si dhe shërbimeve gjyqësore, duke shmangur grumbullimet si në ambientet e gjykatave ashtu dhe brenda sallave gjyqësore.

Rregullat që duhet të miratojnë gjykatat duhet të orientohen drejt (i) garantimit të vijimësisë normale si të veprimtarisë ashtu dhe të shërbimeve gjyqësore në gjykatë (ii) reduktimit të transmetimit të infeksionit midis punonjësve apo dhe përdoruesve të gjykatës; (iii) sigurimit të një ambienti të shëndetshëm në gjykatë. Ato duhet të fokusohen kryesisht në:

1. Respektimin e masave të higjienës sipas rekomandimeve të Institutit të Shëndetit Publik (ISHP) për punonjësit ashtu dhe për të gjithë personat që frekuentojnë mjediset e gjykatës;
2. Për aq sa është e mundur, vendosjen e tunelit të dezinfektimit në hyrjen e godinës së gjykatës, nëpërmjet të cilit duhet të kalojnë të gjithë përdoruesit e gjykatës.
3. Pastrimi dhe dezinfektimi i vazhdueshëm i sipërfaqeve në vendin e punës së stafit të gjykatës dhe në sallat e gjykatës, të mjediseve të tjera, vendosjen dhe përdorimin e produkteve të higjienës, ku përfshihen sapun i duarve, dezinfektantët me bazë alkooli që kanë të paktën 60% alkool, letër të pastrimit të duarve ose peshqir me një përdorim, letra dhe dezinfektantë për pastrimin e sipërfaqeve dhe siguri i koshave të mbyllur për eliminimin e mbetjeve. Në çdo rast përdorimi i tyre bëhet duke përdorur mjetet e mbrojtjes personale;
4. Pajisja e punonjësve dhe përdorimi nga ana e tyre të mjeteve mbrojtëse personale si maska dhe doreza (maskat mund të jenë dhe prej cope dhe të ndërrohen çdo ditë), si një barrierë fizike për minimizimin/kufizimin e transmetimit të infeksionit COVID-19;
5. Respektimi i distancimit fizik midis punonjësve dhe përdoruesve të tjerë të gjykatës duke riorganizuar mjediset e punës për punonjësit si dhe duke vendosur shenja orientuese dhe kontrolluar zbatimin e distancës prej 2 metra. Hartimi i një plani masash për të siguruar distancimin social dhe nëse kapaciteti i punonjësve kalon normën e lejuar për sipërfaqe në m², duke respektuar distancimin fizik prej 2 metra;

6. Vendosja e elementëve të distancimit fizik me shenja vizuale, të dukshme, në sipërfaqen e dyshemesë, si dhe rregullat mbi masat e kufizimit për përhapjen e COVID-19 duhet të jetë e publikuar në mënyrë sa më të dukshme;
7. Kontrolli i respektimit të masave mbrojtëse (përdorimi i maskave dhe dorezave) nga të gjithë pjesëmarrësit në procese gjyqësore dhe përdoruesit e tjerë të gjykatës dhe t'i pajisë me to për aq sa është e mundur.
8. Caktimi i një mjedisi të caktuar për të izoluar një person, i cili mund të shfaqë shenja klinike të sëmundjes dhe më pas të lajmërohet 127-ta dhe Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) përkatëse;
9. Për aq sa është e mundur dhe e lejueshme, vendosjen e kamerave për të vëzhguar nëse masat e përcaktuara të higjienës dhe kujdesit zbatohen me përpikëri;
10. Për aq sa është e mundur, përmirësimin e kontrolleve inxhinierike, me qëllim rritjen e niveleve të ventilimit dhe të përqindjes së ajrit që qarkullon në sistem.
11. Kufizimin e hyrjes së publikut në ambientet e gjykatës, duke garantuar, kundrejt rregullave të vendosura për këtë qëllim, vetëm aksesin e individëve që duhet të kryejnë veprimtari që kanë urgjencë;
12. Vendosjen e posterave që inkurajojnë higjienën e duarve për të ndihmuar në ndalimin e përhapjes, në hyrje të vendit të punës dhe në zona të tjera të vendit të punës ku janë të dukshme;
13. Rregullimin e aksesit në shërbime, me rezervim, edhe nëpërmjet komunikimit telefonik ose elektronik, duke u kujdesur që përdoruesit të mund të përdorin shërbimet brenda një kohe të caktuar, si dhe miratimin e çdo mase që konsiderohet e nevojshme për të shmangur grumbullimet;
14. Rritjen e bashkëpunimit me institucionet të tjera që kanë rëndësi në planifikimin dhe zhvillimin e seancave gjyqësore ashtu dhe në realizimin e komunikimit në distancë nëpërmjet postës elektronike;
15. Nxitjen e përdorimit të komunikimeve elektronike si një mënyrë e preferuar dhe që garanton të njëjtën siguri dhe cilësi si komunikimi shkresor;
16. Detyrimi i personelit gjyqësor të marrë masa edhe lidhur me:
 - a) Ndalimin e përdorimit të telefonave, tavolinave, zyrave ose mjeteve dhe pajisjeve të punonjësve të tjerë, kur është e mundur. Nëse është e nevojshme, ato duhet të pastrohen ose dezinfektohen para dhe pas përdorimit;
 - b) Larjen e duarve ose përdorimin e dezinfektantëve në rast se janë të ndotura apo pas heqjes së maskës dhe dorezave;
 - c) Shmangien dhe mospërdorimin e shtrëngimit të duarve, por metoda të tjera jokontaktuese të përshëndetjes;
 - d) Respektimin e praktikave të etikës respiratore, kollitjes e teshtitjes, nëpërmjet vënies së gropëzës së bërrylit përpara gojës dhe hundës;
 - e) Detyrimin për të deklaruar pranë strukturës përgjegjëse nëse ka pasur kontakt të ngushtë me persona të cilët rezultojnë të jenë të infektuar me Covid-19. Në rast se punonjësi duhet të qëndrojë në vetëkarantinim dhe të njoftojë menjëherë strukturën përgjegjëse e cila më pas njofton NJVKSH përkatës;

- f) Ofrimin e shërbimeve, për aq sa është mundur, nga distance, nëpërmjet komunikimit elektronik, telefonik ose shërbimit postar.

II. MASA ORGANIZATIVE PËR ZHVILLIMIN E VEPRIMTARISË GJYQËSORE

Këshillat e Gjykatave si dhe organet e administrimit gjyqësor, të miratojnë masa për organizimin dhe zhvillimin e veprimtarive gjyqësore, duke u fokusuar ndër të tjera, në:

1. Rritjen e bashkëpunimit me Institucionin e Prokurorisë, Dhomën e Avokatisë, Drejtoritë/Komisariatet e Policisë, Institutin e Mjekësisë Ligjore, Shërbimin e Provës, Zyrat e Shërbimit Social, ekspertët, përkthyesit etj., me qëllim koordinimin mes tyre të planifikimit të seancave gjyqësore, për të mundësuar komunikimin në distancë me gjykatën nëpërmjet postës elektronike² dhe/ose telefonit/faksit;
2. Nxitjen e përdorimit të komunikimeve elektronike si një mjet efikas në kushtet kur distancimi social është shumë jetik në kufizimin e përhapjes së virusit, duke zvogëluar në minimum përdorimin e komunikimit shkresor;
3. Planifikimin, në bashkëpunim me gjyqtarët, të orareve të ndryshme në thirrjen e dëshmitarëve dhe/ose ekspertëve, duke kufizuar, për aq sa është e mundur, thirrjen për të dëshmuar të një numri të madh dëshmitarësh brenda të njëjtës seancë. Ballafaqimi mes dëshmitarëve të bëhet në distancë mes tyre, në respektim të masave kufizuese.
4. Komunikimin me institucione të tjera, në të cilat lind nevoja për të kryer verifikime në vend, duke kërkuar prej tyre krijimin e mundësisë që trupa gjyqësore, sekretari seancës si dhe palët pjesëmarrëse, të priten nga një punonjës, në një ambient më vete që plotëson kushtet higjieno-sanitare dhe ato të distancimit social, pa prezencë të punonjësve të tjerë të institucionit;
5. Në njoftimin e menjëhershëm të palëve dhe pjesëmarrësve në gjykim, në rastet e ekzistencës së shkaqeve objektive që pamundësojnë zhvillimin e një seancë të planifikuar (për të cilat gjykata vihet në dijeni para zhvillimit të seancës);
6. Zbatimin në mënyrë fleksible të kohës ashtu dhe të vendeve të punës, si p.sh. në hartimin e një kalendarit lidhur me përdorimin e sallave të gjykimit, të ndërrimit të orarit të punës/ditëve të punës, apo dhe mundësimin e punës dhe të komunikimeve të disancë (p.sh. telefon, video ose Web);

III. MASA ORGANIZATIVE PËR SHËRBIMET ADMINISTRATIVE TË GJYKATËS

Këshillat e Gjykatave si dhe organet e administrimit gjyqësor, të miratojnë masa për organizimin dhe zhvillimin e shërbimeve gjyqësore, duke u fokusuar ndër të tjera, në:

1. Masa për organizimin e shërbimeve administrative në gjykatë nëpërmjet masave alternative të komunikimit, për të mundësuar ofrimin e shërbimeve nga gjykata duke shmangur, për sa është e mundur grumbullimin e njerëzve në mjediset e gjykatës apo kontaktin fizik të tyre me punonjësit e

²Neni 141 i Kodit të Procedurës Civile parashikon dhe rregullon mënyrën e njoftimit elektronik të akteve. Në paragrafin 4 të këtij neni përcaktohet se: “Rregulla të detajuara për mënyrën e njoftimit elektronik përcaktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë”. Për zbatimin e këtij neni Ministri i Drejtësisë ka nxjerrë urdhrin nr.Nr. 360, datë 5.9.2013 “Për mënyrën e njoftimit elektronik të akteve gjyqësore”. Gjithashtu neni 133 i Kodit të Procedurës Penale parashikon njoftimet e veçanta dhe me mjetet e tjera teknike.

gjykatës dhe me njëri-tjetrin dhe duke respektuar masat higjieno-saintare dhe të distancimit social të parashikuara në pjesën II të këtij udhëzimi.

2. Shërbimet administrative dhe për publikun të organizohen me programim, në orare të caktuara, me komunikim paraprak me qëllim që të mos grumbullohen punonjës dhe/ose qytetarë brenda një ambienti.
3. Masa për të siguruar komunikimin elektronik me administratën e gjykatës për dërgimin e kërkesave për marrje informacioni dhe/ose dokumentacioni (vërtetime, vendime gjyqësore, kopje aktesh etj.) duke publikuar në këndin e njoftimeve dhe faqen e internetit të gjykatës informacionin dhe udhëzimet e nevojshme për realizimin e këtij komunikimi.
4. Masa, për sa është e mundur, për krijimin, publikimin dhe shpërndarjen (nëpërmjet mundësisë së shkarkimit nga faqja e internetit të gjykatës dhe/ose vendosjes në mjedise të përshtatshme në hyrje/jashtë gjykatës) të formularëve tip³ për paraqitjen e kërkesave të palëve, si dhe dërgimin e përgjigjes dhe/ose akteve të kërkuara nga gjykata në rrugë elektronike tek kërkuesit, përveç rasteve kur dokumenti kërkohet në formën e tij fizike dhe duhet të dërgohet nëpërmjet shërbimit postar.
5. Rast pamundësie të komunikimit elektronik për marrjen e shërbimeve nga administrata gjyqësore të vihet në dispozicion të kërkuesve formate tip të kërkesës të cilat duhet të plotësohen dhe të dërgohen në gjykatë në të cilat të njoftohen kërkuesit për të deklaruar numrin e kontaktit dhe/ose adresën e postës elektronike nëpërmjet të cilave do të kontaktohen nga administrata gjyqësore kur kërkesa e tyre të jetë trajtuar. Për kërkesat për marrjen e akteve kërkuesve t'iu komunikohet (me e-mail ose telefon) data dhe ora në të cilën duhet të paraqiten për të marrë shërbimin.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohen Këshillat e Gjykatës, Kryetari dhe Kancelari për marrjen e masave në zbatim të këtij udhëzimi.
2. Pranë çdo gjykate rekomandohet ngritja e strukturës përgjegjëse për zbatimin e masave që do të merren në zbatim të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

KRYETARE

NAUREDA LLAGAMI

³ Formularë të cilët palët mund ti plotësojnë duke aksesuar faqen e gjykatës të cilat duhet të kenë hapësira për deklarimin e pranimin të komunikimit elektronik me gjykatën, adresën e komunikimit elektronik, kontaktin telefonik dhe adresën postare të palëve, si dhe mundësinë për të bashkëlidhur dokumentin e parapagimit të tarifave gjyqësore kur ato kërkohen)